Kuvendi i Komunës së Lipjanit, në mbledhjen e mbajtur me datë 23.09.2026, nxjerrë këtë:

DEKLARATË

Kuvendi i Komunës së Lipjanit, duke respektuar pavarësinë e gjyqësorit, shpreh mospajtimin e tij të thellë me aktgjykimin e shkallës së parë të Dhomave të Specializuara të Kosovës, të datës 16 shtator 2026, ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Kuvendi i Komunës rithekson se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte vazhdimësi e luftës për liri dhe çlirim, e lindur nga rrethanat e rënda të represionit, dhunës, vrasjeve dhe dëbimit të popullsisë shqiptare të Kosovës.

Kuvendi konsideron se, për një dënim penal të kësaj peshe, përgjegjësia personale e secilit të akuzuar duhet të provohet me prova të qarta, konkrete, bindëse dhe përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Kuvendi shpreh shqetësimin e tij se përgjegjësia penale individuale nuk duhet të ndërtohet mbi supozime, përgjithësime, dëshmi të tërthorta apo mbi lidhje të nxjerra nga pozita politike dhe ushtarake që individët kanë mbajtur gjatë luftës.

Kuvendi vlerëson se vetë Trupi Gjykues ka shpallur të akuzuarit të pafajshëm për akuzat për krime kundër njerëzimit, pasi është konstatuar se Prokuroria nuk kishte arritur të provonte, përtej dyshimit të arsyeshëm, ekzistencën e një sulmi të përhapur ose sistematik kundër popullatës civile. Po ashtu, pafajësi janë dhënë lidhur me një numër incidentesh të tjera të pretenduara.

Për Kuvendin e Komunës së Lipjanit, kjo dëshmon rëndësinë themelore që standardi "përtej dyshimit të arsyeshëm" duhet të zbatohet me të njëjtin rigorozitet për çdo akuzë, çdo formë përgjegjësie dhe ndaj secilit të akuzuar veçmas.

Kuvendi konsideron se, kur pas një procesi shumëvjeçar mbeten paqartësi serioze mbi lidhjen konkrete të individit me veprën penale, këto paqartësi nuk mund të plotësohen me perceptime, dëshmi indirekte apo me përgjegjësi të nxjerra vetëm nga hierarkia organizative.

Për këtë arsye, Kuvendi shpreh qëndrimin se, nëse përgjegjësia individuale e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm, me prova bindëse dhe të drejtpërdrejta për elementet përkatëse të veprave penale, rezultati juridik duhet të ishte shpallja e tyre të pafajshëm.

Kuvendi i Komunës shpreh solidaritet me familjet e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, si dhe me të gjithë ata që këtë proces e kanë përjetuar me dhimbje dhe shqetësim.
Kuvendi i Komunës së Lipjanit u bën thirrje qytetarëve të Lipjanit dhe të gjithë Kosovës që, përkundër dhimbjes dhe emocioneve të forta, të ruajnë qetësinë, dinjitetin dhe unitetin, duke shprehur qëndrimet e tyre në mënyrë paqësore dhe institucionale.
Kuvendi i Komunës së Lipjanit i bënë thirrje institucioneve kompetente qëndrore të bashkërendojnë aktivitetet dhe veprimet e nevojshme shtetërore në mbrojtjen e vlerave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në fund, duhet të theksojmë se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është fundi i procesit. Procedura e ankimit është pjesë e drejtësisë dhe ne duhet të shprehim pritjen që aty të shqyrtohen me kujdes të gjitha pretendimet, provat dhe çështjet që lidhen me përgjegjësinë individuale.

Duke pasur parasysh se vendimi u shpall me formulimin "Në emër të popullit të Kosovës", Kuvendi i Komunës së Lipjanit përcjell qartë mesazhin e qytetarëve të saj:

"JO NË EMRIN TIM!"

Kjo është shprehje e mospajtimit me këtë dënim dhe e të drejtës për të kërkuar drejtësi për udhëheqësit e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi.

15Nr. 700/01-51324
Lipjan, më 23.09.2026

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi